



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË
KRYETARI**

Nr. 4749 prot.

Tiranë, më 20.4.2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim dhe miratim

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim relacionin dhe projektvendimin "Për dhënien e pëlqimit sipas kërkesës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompesimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse, pjesë e paketës Anti-Krizë".

Me respekt,

KRYETARI

Erion VELIAJ

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI**

Anuela Ristani



RELACION

“PËR DHËNIEN E PËLQIMIT SIPAS KËRKESËS SË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS SË KOMPESIMIT PËR SHOQËRITË E LINJAVE TË TRANSPORTIT QYTETËSE, RRETHQYTETËSE DHE NDËRQYTETËSE, PJESË E PAKETËS ANTI-KRIZË”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 6, nenit 54 dhe nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Investimeve dhe Monitorimit të Punëve Publike, paraqet sa më poshtë vijon:

Pranë Bashkisë Tiranë është depozituar shkresa me nr. 3348 prot., datë 17.04.2026, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me nr. 14304, datë 17.06.2026, me anë të së cilës dërgohet për mendim projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompesimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse, pjesë e paketës Anti-Krizë”.

Referuar materialit të përcjellë, rezulton se projektvendimi synon kompensimin e shoqërive të transportit për linjat qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse në masën 50 lek për litër karburanti, për një periudhë tre mujore, mars, prill, maj 2026. Kompensimi do të bëhet për shumën e konsumit të karburantit për periudhën mars, prill, maj 2026, por jo më shumë se sasia e konsumuar për të njëjtën periudhë të vitit 2025, për secilën nga shoqëritë. Gjithashtu, referuar relacionit që shoqëron projektvendimin e dërguar bëhet me dije si vijon:

Çmimet e nënprodukteve të naftës dhe gazit kanë shënuar një tjetër rekord të lartë, si pasojë e krizës energjitike globale. Këto tregojnë qartë se lufta vazhdon të rrisë presionin në sistem, ndërkohë që rreziku i ndërprerjes së furnizimeve ende nuk është vlerësuar plotësisht dhe duhet të jemi të gatshëm për një rritje të mëtejshme të çmimeve.

Ndër të tjera, ndikimet e rritjes së çmimit të naftës kanë implikime të dukshme dhe kritike për sektorin e transportit, si dhe konkurrencën e tij të përgjithshme, duke shtuar presionin mbi flotat e mjeteve dhe transportuesit e vegjël.

Në përgjigje të kësaj situatë, kërkohet një ndërhyrje e Qeverisë, për t'i ardhur në ndihmë sektorit të transportit për tu përballur me rritjen e çmimit të naftës, dhe që do të ndihet direkt tek kostot operacionale të transportit të mallrave, në kostot e përdorimit të shërbimeve të transportit, qoftë ai publik apo privat direkt, e si rrjedhojë me një impakt direkt tek qytetarët, si pasagjerë, apo si konsumatorë.

Në Shqipëri, transporti rrugor përben rreth 98 % të volumit të përgjithshëm të transporteve shqiptare dhe si i tillë është transporti që ndikon më shumë në jetën ekonomike dhe sociale. Si në të gjithë vendet e BE-së, edhe në Shqipëri transporti rrugor është konsumatori më i madh i hidrokarbureve dhe njëkohësisht edhe ndotësi më i madh nga të gjitha industritë.

Infrastruktura rrugore e Shqipërisë përbehet nga rreth 18,000 km rrugë, prej të cilave 3,680 km janë rrjet kombëtar (shtetëror) ne varësi të ARRSH.

Transporti në linjë të rregullt udhëtarësh ndërqytetës me autobus kryhet nëpërmjet rrjetit të linjave prej 439 linja që operohen prej 242 subjektesh të licencuar dhe 2179 autobusë të çertifikuar, me një total prej 1,851 orare operimi duke përshkruar rreth 9 milion km në muaj, si edhe në linja rrethqytetëse apo linja urbane, veçanërisht në kryeqytet.

Ka 210 linja të rregullta ndërkombëtare për transport udhëtarësh me autobus që kanë origjinën dhe destinacionin në territorin shqiptar dhe që transportojnë udhëtarë në të gjithë Evropën, si edhe një numër linjash të rastit të transporteve turistike ndërkombëtare.

Flota e mjeteve rrugore motorrike në Shqipëri përbehet nga 670,120 automjete, prej të cilave rreth 133,392 janë me benzinë, 482,280 janë diesel dhe të tjerat janë automjete elektrike apo hibride, ndërkohë që 81.2% e numrit të përgjithshëm të automjeteve janë autovetura, 1.2% janë autobusë dhe 2.1% janë kamionë për transport mallrash.

Automjetet e transportit ndërkombëtar të mallrave janë rreth 3,100 kamionë. Ndërkohë, që në një vit kryhen rreth 1,825 udhëtime turistike ndërkombëtare të rastit me autobus në baze të marrëveshjes Interbus.

Numri ditor i udhëtarëve që qarkullojnë në territorin e Shqipërisë me autovetura private dhe automjetet e transportit publik është 344,317, numri i udhëtarë për km është 38,111,910 dhe gjatësia mesatare e udhëtimit në km është 111. Ndërkohë, numri i mesatar i udhëtarëve për një automjet është 2.1 udhëtarë për autoveturë, 21 udhëtarë për minibus dhe 38.7 për autobus.

Fluksi ditor i udhëtarëve hyrje/dalje në të gjitha qarqet dhe bashkitë e vendit është 137,000 udhëtarë ose 50 milion udhëtarë në vit.

Të dhënat e mësipërme, janë tregues të qartë, të impaktit që do të ketë një politikë subvencioni e Qeverisë, tek qytetarët dhe tek ekonomia e vendit, por duke besuar fort se çelësi i tranzicionit të energjisë është në duart tona, ndryshimi i madh i kërkuar duhet të udhëhiqet nga konsumatorët dhe individët.

Për sa më sipër, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje optimale dhe të domosdoshme në shërbim të transportit publik propozohet kompesimi i shoqërive të transportit për linjat qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse në masën 50 lek për liter, për një periudhë tre mujore, mars, prill, maj 2026.

Referuar pikës 1, të kreut I, të projektvendimit, parashikohet se kompensimi i shoqërive të transportit për linjat qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse në masën 50 lek për liter karburanti, për një periudhë tre mujore, mars, prill, maj 2026. Kompensimi do të bëhet për shumën e konsumit të karburantit për periudhën mars, prill, maj 2026, por jo më shumë se sasia e konsumuar për të njëjtën periudhë të vitit 2025, për secilën nga shoqëritë.

Në vijim, referuar pikës 2, të këtij kreu, parashikohet se efektet financiare prej 250 milion lekësh, do të përballohen nga:

- a. Fondi rezervë i buxhetit të shtetit
- b. Buxheti i Bashkisë Tiranë respektivisht për shoqëritë e linjave qytetase të Tiranës.

Në vijim, në kreun II, të projektvendimit janë parashikuar kriteret dhe dokumentacioni për përfitim të kompesimit. Dokumentacioni i cili duhet të paraqitet nga subjektet kërkuese, parashikohet në pikën 2, të këtij kreu dhe nis me kërkesën e subjektit pranë administratës tatimore nën juridiksionin e së cilës është regjistruar, e cila bën dhe verifikimin e këtij dokumentacioni. Gjithashtu, në këtë kre, rregullohet dhe procedura për paraqitjen e kërkesave, si dhe trajtimi i tyre nga administrata tatimore.

Në fund në kreun III, projektvendimi në fjalë, parashikon se kërkesat për kompesim do të pranohen deri më datë 1 gusht 2026, si dhe se efektet financiare prej 250 milion lekësh, do të përballohen nga:

- a. Fondi rezervë i buxhetit të shtetit
- b. Buxheti i Bashkisë Tiranë respektivisht për shoqëritë e linjave qytetase të Tiranës.

Në pikën 3, të këtij kreu ngarkohen Ministria e Financave, Bashkia Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Lidhur me sa më sipër, referuar parashikimeve të pikës 6, të nenit 23, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre, për transportin publik vendor.

Për sa më sipër, duke pasur parasysh impaktin pozitiv që sjell, për t’i ardhur në ndihmë sektorit të transportit për tu përballur me rritjen e çmimit të naftës, dhe që do të ndihet direkt tek kostot operacionale të transportit të mallrave, në kostot e përdorimit të shërbimeve të transportit, qoftë ai publik apo privat direkt, e si rrjedhojë me një impakt direkt tek qytetarët, si pasagjerë, apo si konsumatorë, i propozojmë Këshillit Bashkiak, miratim të projektvendimit “Për dhënien e pëlqimit sipas kërkesës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompesimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse, pjesë e paketës Anti-Krizë”.

Duke shpresuar në miratimin e këtij projektvendimi nga ana juaj,

Z. Lisjen Qendro

Specialist, Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor

Z. Ronaldo Hasa

Specialist, Sektori i Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

Znj. Joana Shahini

Përgjegjëse, Sektori i Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

Z. Enton Punavija

Drejtor, Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor




Z. Enton Punavija

Drejtor i Komanduar, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Investimeve dhe Monitorimit të Punëve Publike

Z. Erion Çaka

Drejtor, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit




Znj. Berta Piro

Drejtor, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar



Z. Eldi Hoxha

Sekretar i Përgjithshëm



Znj. Vasilika Vjero

Zv/Kryetar i Bashkisë Tiranë



BASHKIA
TIRANË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ datë _____ 2026

**“PËR
DHËNIEN E PËLQIMIT SIPAS KËRKESËS SË MINISTRISË SË
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË
DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS SË KOMPESIMIT PËR SHOQËRITË E
LINJAVE TË TRANSPORTIT QYTETËSE, RRETHQYTETËSE DHE
NDËRQYTETËSE, PJESË E PAKETËS ANTI-KRIZË”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 6, nenit 54 dhe nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, shkresës me nr. 3348 prot., datë 17.04.2026 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me nr. 14304, datë 17.04.2026, si dhe në vijim të memos së Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit të Investimeve dhe Monitorimit të Punëve Publike, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Dhënie e pëlqimit sipas kërkesës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompesimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës, pjesë e paketës Anti-Krizë”.
2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Investimeve dhe Monitorimit të Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

MEGI FINO




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr. 3348 prot.

Tiranë, më 17.04.2026

Lënda: Dërgohet për mendim një projektvendim.



BASHKIA TIRANË
Adresa: Sheshi Skënderbej, Tiranë

Bashkëlidhur ju dërgojmë për mendim, projektvendimin “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës, pjesë e paketës anti-krizë”, së bashku me relacionin shpjegues në të cilën parashikohet mbulimi i shpenzimeve për shoqëritë e linjave qytetase të Tiranës, nga Bashkia Tiranë.

Mbetemi në pritje të dakordësisë suaj për vijimin e procedurave të mëtejshme.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____

“PËR
PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS
SË KOMPENSIMIT PËR SHOQËRITË E LINJAVE TË TRANSPORTIT
QYTETËSE, RRETHQYTETESE DHE NDËRQYTETËSE, PJESË E PAKETËS
ANTI – KRIZË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Kompesimin e shoqërive të transportit për linjat qytetëse, rrethqytetase dhe ndërqytetase në masën 50 lek për litër karburanti, për një periudhë tre mujore, mars,prill maj 2026. Kompensimi bëhet për shumën e konsumimit të karburantit për periudhën mars,prill maj 2026, por jo më shumë se sasia e konsumuar për të njëjtën periudhë të vitit 2025, për secilën nga shoqëritë.
2. Efektet financiare prej 250 milion lekë (dyqind e pesëdhjete milion) do të përballohen nga:
 - a) Fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
 - b) Buxheti i bashkisë Tiranë respektivisht për shoqëritë e linjave qytetase të Tiranës.

II. KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR PËRFITIMIN E KOMPENSIMIT

1. Kërkesa për të përfituar kompensimin financiar, të përcaktuar në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, bëhet nga subjekti çdo muaj pranë administratës tatimore nën juridiksionin e së cilës është regjistruar, e cila bën verifikimin e dokumentacionit të paraqitur.

2. Subjektet kërkuese duhet të paraqesin pranë administratës tatimore, nën juridiksionin e së cilës janë regjistruar, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesën, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) kopje të licencës respektive të vlefshme për transportin qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas;
- c) të dhënat identifikuese të subjektit tatimpagues të pajisur me NIUS;
- ç) emrin e bankës, ku subjekti përfitues ka llogarinë rrjedhëse bankare;
- d) IBAN-in e llogarisë bankare (jo më shumë se 28 karaktere dhe në monedhën lek);

dh) Për shoqëritë që kryejnë vetëm aktivitetet të transportit qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas, kopje të faturave fizike të furnizimit me karburant për periudhën mars, prill maj, të vitit 2025 dhe vitit 2026,

e) Për shoqëritë që përveç aktivitetit të transportit qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas ushtrojnë edhe aktivitete të tjera, përveç kopjeve të faturave fizike të furnizimit me karburant për periudhën mars, prill maj, të vitit 2025 dhe 2026, duhet të paraqesin edhe:

- i) vetdeklarim të sasisë së karburantit të përdorur për transportin qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas;
- ii) Kopje të fletë daljeve të karburantit gjatë muajve prill, maj, qershor të vitit 2025 dhe vitit 2026, të përdorur për transportin qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas, sipas targave të mjeteve.

3. Kërkesat nga subjektet paraqiten pas datës 10 të muajit pasardhës duke filluar nga muaji prill 2025.

4. Në rastin kur konstatohen se në dokumentet e dorëzuara nga subjekti janë të paplota apo kanë mangësi, administrata tatimore, brenda 5 (pesë) ditëve pune, e kthen kërkesën me qëllim plotësimin e dokumentacionit.

5. Administrata tatimore pas verifikimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, dërgon pranë degës përkatëse të thesarit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune, udhërshpenzimet, duke bashkëlidhur listën përmbledhëse të subjekteve përfituese, sipas bankave të nivelit të dytë, ku përfituesit kanë llogarinë e tyre bankare.

6. Për shoqëritë e regjistruara pas muajit maj 2025, si vlerë reference për kompesim, do të merret vlera më e lartë e konsumit të karburantit, për periudhën janar – shkurt 2026.

7. Me qëllim shmangien e abuzimit, strukturat e administratës tatimore, mund të kryejnë edhe verifikime në vend, në rast konstatimi të pasaktësive në dokumentacionin e

paraqitur në kërkesë. 8. Struktura e thesarit në degë, mbas marrjes së urdhërshpenzimit me listën e përfituesve, sipas pikës 5, të këtij kreu, kryen pagesën brenda 5 (pesë) ditëve pune.

8. Struktura e thesarit në degë, mbas marrjes së urdhërshpenzimit me listën e përfituesve, sipas pikës 5, të këtij kreu, kryen pagesën brenda 5 (pesë) ditëve pune.

III. ÇËSHTJE TË FUNDIT

1. Kërkesat për kompensim do të pranohen deri në datë 1 gusht 2026.
2. Efektet financiare prej 250 milion (dyqind e pesëdhjete milion) do të përballohen nga:
 - a) Fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
 - b) Buxheti i bashkisë Tiranë respektivisht për shoqëritë e linjave qytetase të Tiranës.
3. Ngarkohen Ministria e Financave, Bashkia Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

SHTOJCA NR. 1

KËRKESË

EMRI I SUBJEKTIT _____

NIPT _____

Banka _____ (vetëm për bankat aktive)

Iban (LEK) _____ (Jo më shumë se 28 karaktere)

*Bashkëlidhur kësaj kërkesë:

- Kopja e licencës aktive;
- Vërtetimi i lëshuar nga banka për llogarinë bankare;
- Kopje të faturave fizike të furnizimit me karburant për periudhat: prill, maj, qershor 2026

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN

“PËR

**PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE
TË MASËS SË KOMPENSIMIT PËR SHOQËRITË E LINJAVE TË
TRANSPORTIT QYTETËS, RRETHQYTETES DHE NDËRQYTETËS,
PJESË E PAKETËS ANTI – KRIZË”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN**

Ky projektvendim synon kompesimin e shoqërive të transportit për linjat qytetëse, rrethqytetese dhe ndërqytetëse në masën 50 lek për litër karburanti, për një periudhë tre mujore, mars, prill, maj 2026. Kompensimi do të bëhet për shumën e konsumimit të karburantit për periudhën mars, prill, maj 2026, por jo më shumë se sasia e konsumuar për të njëjtën periudhë të vitit 2025, për secilën nga shoqëritë.

Efektet financiare prej 250 milion (dyqind e pesëdhjetë milionë) do të përballohen nga

- a) fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
- b) buxheti i bashkisë Tiranë respektivisht për shoqëritë e linjave qytetase të Tiranës.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA
POLITIKE**

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetëse, rrethqytetese dhe ndërqytetëse, pjesë e paketës anti – krizë”.

Ky projektvendim nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve të parashikuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për vitin 2026.

III. PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME TË KËTLI PROJEKTVENDIMI

Çmimet e nënprodukteve të naftës dhe gazit kanë shënuar një tjetër rekord të lartë, si pasojë e krizës energjitike globale. Këto tregojnë qartë se lufta vazhdon të rrisë presionin në sistem, ndërkohë që rreziku i ndërprerjes së furnizimeve ende nuk është vlerësuar plotësisht dhe duhet të jemi të gatshëm për një rritje të mëtejshme të çmimeve.

Ndër të tjera, ndikimet e rritjes së çmimit të naftës, kanë implikime të dukshme dhe kritike për sektorin e transportit, si dhe konkurrencën e tij të përgjithshme, duke shtuar presionin mbi flotat e mjeteve dhe transportuesit e vegjël.

Në përgjigje të kësaj situatë, kërkohet një ndërhyrje e Qeverisë, për të ardhur në ndihmë sektorit të transportit për tu përballur me rritjen e çmimit të naftës, dhe që do të ndihet direkt tek kostot operacionale të transportin e mallrave, në kostot e përdorimit të shërbimeve të transportit, qoftë ai publik apo privat direkt, e si rrjedhojë me një impakt direkt tek qytetarët, si pasagjerë, apo si konsumatorë.

Në Shqipëri, transporti rrugor përben rreth 98 % të volumit të përgjithshëm të transporteve shqiptare dhe si i tillë është transporti që ndikon më shumë në jetën ekonomike dhe sociale. Si në të gjithë vendet e BE-së, edhe në Shqipëri transporti rrugor është konsumatori më i madh i hidrokarbureve dhe njëkohësisht edhe ndotësi më i madh nga të gjitha industritë.

Infrastruktura rrugore e Shqipërisë përbehet nga rreth 18,000 km rrugë, prej të cilave 3,680 km janë rrjet kombëtar (shtetëror) në varësi të ARRSH.

Transporti në linjë të rregullt udhëtarësh ndërqytetës me autobus kryhet nëpërmjet rrjetit të linjave prej 439 linja që operohen prej 242 subjektsh të licencuar dhe 2179 autobusë të certifikuar, me një total prej 1,851 orare operimi duke përshkuar rreth 9 milion km në muaj, si edhe në linja rrethqytetëse apo linja urbane, veçanërisht në kryeqytet.

Ka 210 linja të rregullta ndërkombëtare për transport udhëtarësh me autobus që kanë origjinën dhe destinacionin në territorin shqiptar dhe që transportojnë udhëtarë në të gjithë Evropën, si edhe një numër linjash të rastit të transporteve turistike ndërkombëtare.

Flota e mjeteve rrugore motorrike në Shqipëri përbehet nga 670,120 automjete, prej të cilave rreth 133,392 janë me benzinë, 482,280 janë diesel dhe te tjerat janë automjete elektrike apo hibride, ndërkohë që 81.2% e numrit të përgjithshëm të automjeteve janë autovetura, 1.2% janë autobusë dhe 2.1% janë kamionë për transport mallrash.

Automjetet e transportit ndërkombëtar të mallrave janë rreth 3,100 kamionë. Ndërkohë, që në një vit kryhen rreth 1,825 udhëtime turistike ndërkombëtare të rastit me autobus në baze të marrëveshjes Interbus.

Numri ditor i udhëtarëve që qarkullojnë në territorin e Shqipërisë me autovetura private dhe automjetet e transportit publik është 344,317, numri i udhëtarë për km është 38,111,910 dhe gjatësia mesatare e udhëtimit në km është 111. Ndërkohë, numri i mesatar i udhëtarëve për një automjet është 2.1 udhëtarë për autoveturë, 2.1 udhëtarë për minibus dhe 38.7 për autobus.

Fluksi ditor i udhëtarëve hyrje/dalje në të gjitha qarqet dhe bashkitë e vendit është 137,000 udhëtarë ose 50 milion udhëtarë në vit.

Të dhënat e mësipërme, janë tregues të qartë, të impaktit që do të ketë një politikë subvencioni e Qeverisë, tek qytetarët dhe tek ekonomia e vendit, por duke besuar fort se çelësi i tranzicionit të energjisë është në duart tona, ndryshimi i madh i kërkuar duhet të udhëhiqet nga konsumatorët dhe individët.

Për sa më sipër, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje optimale dhe të domosdoshme në shërbim të transportit publik propozojmë kompesimin e shoqërive të transportit për linjat qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse në masën 50 lek për liter, për një periudhë tre mujore, mars, prill, maj 2026.

METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË SUBVENCIONIT TË KARBURANTIT

Paketa e Rezistencës – Transporti Rrugor i Pasagjerëve

Periudha e Subvencionimit: Mars – Prill – Maj 2026 | Norma: 50 Leka/Liter

TREGUESIT KRYESORË TË SEKTORIT

Treguesi	Vlera	Njësia	Burimi / Shënim
----------	-------	--------	-----------------

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse, pjesë e paketës anti – krizë”.

Numri i linjave ndërqytetëse	439	Linja	Ministria e Infrastrukturës
Numri i subjekteve të licencuara	242	Subjekte	Ministria e Infrastrukturës
Numri i autobusëve të certifikuar	2,179	Autobus	Ministria e Infrastrukturës
Totali i orareve të operimit	1,851	Orare	Ministria e Infrastrukturës
Distanca mujore e përshkuar	9,000,000	km/muaj	Ministria e Infrastrukturës
Udhëtarë ditore (të gjithë mjetet)	344,317	Udhëtarë/ditë	Të dhëna operative
Mesatare udhëtarësh – Autoveturë	2.1	udh./mjet	Koeficient mesatar
Mesatare udhëtarësh – Minibus	21	udh./mjet	Koeficient mesatar
Mesatare udhëtarësh – Autobus	38.7	udh./mjet	Koeficient mesatar

II. PARAMETRAT E LLOGARITJES (Inpute)

Parametri	Vlera Input	Njësia	Shënim
Norma e subvencionit	50	Lekë/Litër	Sipas Paketës së Rezistencës
Çmimi mesatar i karburantit	160	Lekë/Litër	Çmim supozuar (bazë llogaritje)
Numri i muajve të subvencionimit	3	Muaj	Mars, Prill, Maj 2026

II.A. TRANSPORTI URBAN I PASAGJERËVE

Zëri i llogaritjes	Formula / Vlera	Njësia	Shpjegim
Blerja vjetore e karburantit (Urban)	2,000,000,000	Lekë/vit	Të dhënë direkte nga sektori urban
Sasia vjetore e karburantit (Urban)	12,500,000	Litra/vit	Formula: Blerja vjetore / Çmimi mesatar
Sasia mujore e karburantit (Urban)	1,041,667	Litra/muaj	Formula: Sasia vjetore / 12 muaj
Subvencioni mujor (Urban)	52,083,333	Lekë/muaj	Formula: Litra/muaj x Norma e subvencionit
Subvencioni 3-mujor (Urban)	156,250,000	Lekë	Formula: Subvencioni mujor x 3 muaj

II.B. TRANSPORTI TË TJERA RRUGORE TË PASAGJERËVE (Ndërqytetës + Rrethqytetës)

Zëri i llogaritjes	Formula / Vlera	Njësia	Shpjegim
Blerja vjetore e karburantit (Tjera transp.)	800,000,000	Lekë/vit	Të dhënë direkte nga transporti tjetër
Sasia vjetore e karburantit (Tjera transp.)	5,000,000	Litra/vit	Formula: Blerja vjetore / Çmimi mesatar

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfuturit për shoqëritë e linjave të transportit qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës, pjesë e paketës anti – krizë”.

Sasia mujore e karburantit (Tjera transp.)	416,667	Litra/muaj	Formula: Sasia vjetore / 12 muaj
Subvencioni mujor (Tjera transp.)	20,833,333	Lekë/muaj	Formula: Litra/muaj x Norma e subvencionit
Subvencioni 3-mujor (Tjera transp.)	62,500,000	Lekë	Formula: Subvencioni mujor x 3 muaj

IV. TOTALI I SUBVENCIONIMIT – TË DY SEKTORËT

Sektori	Mujor (Lekë)	3-Mujor (Lekë)	Shënim
Urban	52,083,333	156,250,000	Burim: Seksioni III.A
Ndërqytetës + Rrethqytetës	20,833,333	62,500,000	Burim: Seksioni III.B
TOTALI	72,916,667	218,750,000	Urban + Transporte te tjera rrugore

V. KUSHTI KUFIZUES – KOMPENSIMI MAKSIMAL

Kompensimi bëhet për sasinë e karburantit të konsumuar gjatë periudhës mars–maj 2026, por NUK MUND TË JETË MË SHUMË se sasia e konsumuar për të njëjtën periudhë të vitit 2025, për secilën shoqëri transporti veç e veç.

Kufiri: $\min(\text{Konsum } 2026, \text{Konsum } 2025) \times 50 \text{ Lekë/Litrë}$

VI. TË PËRCAKTOHET NË NJËRIKËT

■ Inpote / Të dhëna bazë (blu)		
■ Formula / Llogaritje (zi)		
■ Rezultate ndërmjetëse (gjelbër)		
■ Totale sektoriale (verdhë ar)		
■ TOTAL FINAL (verdhë e ndezur)		

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi i paraqitur është në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës, dhe të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe ligjit nr.87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026".

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse, pjesë e paketës anti-krizë".

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNITAIRE*

Ky projektvendim nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi përbëhet nga tre krerë, me përmbajtje si më poshtë:

Kreu I "*TË PËRGJITHSHME*", ka në përmbajtje 2 pika në të cilat jepen parashikimelidhur me mënyrën e kompesimit për shoqëritë e transportit për linjat qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse si dhe caktimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si njësi zbatuese, për kryerjen e procedurave të kompesimit.

Kreu II "*KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR PËRFITIMIN E KOMPENSIMIT*", ka në përmbajtje 7 pika në të cilat jepen parashikime lidhur me mënyrën e aplikimi për të përfituar kompesimin financiar, dokumentacioni që duhet të dorëzohet në DRT nga subjektet aplikuese.

Kreu III "*ÇËSHTJE TË FUNDIT*", ka në përmbajtje 3 pika në të cilat parashikohet se si do të realizohen kërkesat për kompensim, përballimi i efekteve financiare dhe institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e aktit ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse, pjesë e paketës anti-krizë".

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare prej 250 milion (dyqind e pesëdhjetë milionë) do të përballohen nga

- a) fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
- b) buxheti i bashkisë Tiranë respektivisht për shoqëritë e linjave qytetase të Tiranës.

MINISTRI I FINANCAVE

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Petrit Malaj

Enea Karakaçi